

HULUMTIM

POZITA E FEMRES – PJESETARE NE FORCEN E SIGURISE SE KOSOVES

Perspektiva Gjinore e integruar dhe pjesëmarrja e rritur e grave në strukturat e FSK-së

NJDNJ

MFSK, tetor 2015

I. **HYRJA:**

Ky hulumtim është realizuar nga Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në MFSK, është njëri nga aktivitetet që po realizohet për implementimin e Planit të Veprimit për zbatim të Rezolutës 1325 “ Gratë, Paqja dhe Siguria” të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Në këtë hulumtim janë analizuar statistikat dhe pjesëmarrja e rritur e femrave në strukturat e FSK-së, pozita e femrave pjesëtare e FSK si dhe vështirësitë që hasin femrat pjesëtare të FSK-së në kryerjen e detyrave të tyre.

Po ashtu, flitet edhe për rëndësinë dhe kompetencat që ka Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në MFSK.

QËLLIMI:

Qëllimi i këtij hulumtimi është analiza e perspektives gjinore në FSK, pjesëmarrja e rritur e femrave në strukturat e FSK-së si dhe identifikimi i shkaqeve të rënies së numrit të femrave në këto struktura.

II. METODAT E HULUMTIMIT

Ky hulumtim u realizua në një periudhë kohore prej një muaji dhe në përputhje me afatin kohor të paraparë në Planin e Veprimit për vitin 2015. Në këtë hulumtim kemi aplikuar metodologjinë më efektive për mbledhjen e të dhënave për hulumtim.

Anketa

Janë realizuar 151 anketa me femra të uniformuara në pozita të ndryshme në FSK, prej tyre edhe pjesëtare të komuniteteve të ndryshme, disa prej të cilave kanë plotësuar pyetësin në gjuhën e tyre.

Pyetësorët janë plotësuar në këto njësi:

BAT.-I- në BRSH, Gjilan; BAT –II-të në Istog; BAT-III- të në Mitrovicë; Regjimenti i Mbrojtjes Civile (RMC) Prizren; Regjimenti i Mbrojtjes Civile në Pomozetin; Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), Ferizaj; Komanda e Forcave Tokësore (KFT), në Kazermën “Adem Jashari” në Prishtinë; Brigada e Mbështetjes Operacionale (BMO), Batalioni i Xhenios (BXH), Qendër për Studime Universitare (QSU), Kompaninë e Mjekësisë (KM) ; Njësia Ndërlidhëse për Reagim ndaj Krizave (NJNRK); në Policinë e Forcës (PF).

Konsultimi i gjithë materialit në disponim në Forcën e Sigurisë së Kosovës (raporteve dhe Statistikave) po ashtu plotësimi me informacione dhe të gjetura me anë të pyetësorëve të përpiluar nga ana e NJDNJ-së, për të ruajtur anonimitetin, shërbyen si metodologji bazë për hulumtim. Target grupe të hulumtimit ishin femrat të cilat shërbejnë në Forcën e Sigurisë së Kosovës në të gjitha strukturat. Ky hulumtim ka një rëndësi të veçantë sepse përmban të dhëna reale, të besueshme, e që do të thotë se rezultatet nuk mbështeten në konstatime por në të dhëna burimore dhe objektive. Ruajtja e anonimitetit dhe etika në punë ishte prioritet i hulumtimit, për arsye të evitimit të pengesave eventuale që mund të hasin të intervistuarit.

III. KORNIZA LIGJORE QË GARANTON TË DREJTAT E NJERIUT DHE BARAZINË GJINORE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Ligji për Barazi Gjinore
- Ligji Kundër Diskriminimit
- Ligji për Shërbim Civil të republikës së Kosovës

IV. KUADRI LIGJOR EKZISTUES DHE POLITIKAT AFIRMATIVE PËR BARAZI GJINORE NË MFSK/FSK

Infrastruktura ligjore në MFSK dhe FSK ofron sigurimin bazë për mundësi të barabarta dhe mos diskriminim në baza gjinore. Ndërsa hartimi dhe miratimi i Politikës për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore (MFSK, 2011), ka ndihmuar në përqendrimin e vëmendjes më të madhe për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, integrimin e të drejtave të njeriut, përmirësimin e balancës gjinore, forcimin e rolit të femrës, zgjerimin dhe thellimin e bashkëpunimit brenda institucional (themelimi i rrjetit-2011) etj.

NJËSIA PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE BARAZI GJINORE

Në kuadër të MFSK-së nga nëntori i vitit 2009, funksionon Njësia për të Drejtat e Njeriut, e cila siguron që funksionet ekzekutive dhe aktivitetet e MFSK-së dhe FSK-së të afirmojnë llogaridhënien e brendshme dhe përputhjen me standardet e pranuar ndërkombëtarisht të të Drejtave të Njeriut.

Njësia e të Drejtave të Njeriut (NJDNJ) është në vartësi të drejtpërdrejtë të Sekretarit të Përgjithshëm. Përbehet nga dy punonjës, të cilët janë shërbyes civil. NJDNJ vepron si një mekanizëm këshillues, monitorues dhe rekomandues Brenda MFSK-së dhe FSK-së, për të drejtat

e njeriut. Për të arritur këtë, NJDNJ ka për qëllim të mbrojë, avancojë dhe afirmojë të drejtat e njeriut.

NJDNJ aktivitetin e shtrinë edhe në sferën e barazisë gjinore dhe mundësive të barabarta si element i rëndësishëm për zhvillim të qëndrueshëm, i cili nuk mundë të arrihet pa fuqizimin e femrës, sepse roli i saj është dëshmuar në të gjitha fushat e jetës dhe punës. NJDNJ gjithashtu mbron edhe të drejtat e komuniteteve duke u angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për krijimin e një ambienti të volitshëm, për mundësi dhe qasje të barabartë të të gjithëve në të gjitha sferat, me qëllim që punët dhe përgjegjësitë në nivel ministror të kryhen pa asnjë dallim sa i përket gjinisë, gjuhës, përkatësisë kombëtare apo fetare.

GJENDJA AKTUALE E PËRQINDJES GJINORE NË MFSK DHE FSK

Përqindja e femrave në MFSK është 32% ndërsa, përqindja e femrave të uniformuara në MFSK/FSK është 8.52%, përkatësisht 203 femra në uniformë në gradën e oficerit, nënoficerit dhe ushtarit.

Në gradën e Kolonelit kemi një (1) femër, përkatësisht zëvendëskomandant në Komandën e Doktrinës dhe Stërviçjes.

- Në gradën e Nënkolonelit kemi dy (2) femra
- Në gradën e Majorit kemi pesë (5) femra
- Në gradën e Kapitenit kemi katër (4) femra
- Në gradën e togerit nëntë (9) frmera
- Në gradën në nëntoger (0)
- Në gradën rreshter major i parë (0)
- Në gradën rreshter major dy (2)
- Në gradën kapter dhjetë (10)
- Në gradën rreshter tetë (8)
- Në gradën tetar pesëdhjetë (15)
- Ushtar njëqind e dyzet e shtatë (147)

Emërtimi i Gradave	Femra	Meshkuj	Total
OF-8 Gjenerallejtënant	0	1	1
OF-7 Gjeneralmajor	0	0	0
OF-6 Gjeneral brigade	0	5	5
OF-5 Kolonel	1	14	15
OF-4 Nënkolonel	2	33	35
OF-3 Major	5	83	88
OF-2 Kapiten	4	91	95
OF-1 Toger	9	60	69
OF-1 Nëntoger	0	33	33
OR-9 Rreshter major i parë	0	14	14
OR-8 Rreshter major	2	52	54
OR-7 Kapter	10	160	170
OR-5 Rreshter	8	325	333
OR-3 Tetar	15	543	558
OR-1 Ushtar	147	767	914

Kadetët që kanë diplomuar dhe që do të diplomojnë në qendrën e studimeve universitare në FSK.

Komunitetet	VITET E DIPLOMIMIT TE KADETEVE NE QSU																						GJITHSEJ
	2009		2010		2011		2012		2013		2014		2015		2016		2017		2018		2019		
	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	
Shqiptar	10	1	8	2	16		9	2	10		6		12		10	1	7		11	3	10	2	120
Ashkali															1								1
Boshnjak			1																				1
GJITHSEJ	10	1	9	2	16	0	9	2	10	0	6	0	12	0	11	1	7	0	11	3	10	2	122
	11		11		16		11		10		6		12		12		7		14		12		

Vitet e diplomimit te pjesetareve qe studijone ne Akaemine Maqedone.

	VITET E DIPLOMIMIT												GJITHSEJ
	2016		2017		2018		2019		2020		2021		
	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	
Shqipetar					1		1						2
Boshnjak	2		1		2		1						6
Serb	2		1										3
	4	0	2	0	3	0	2	0	0	0	0	0	11
	4		2		3		2		0		0		

Nga ky grup i pjesetareve qe studijojne ne Akademine Maqedone, prej tyre jane 5 Kadete nga jeta civile dhe 6 Ushtar te FSK.

Po ashtu ne vitin 2015 kane filluar studimet kadete edhe ne Akademine Ushtarake ne Kroaci dhe ne Akademine Ushtarake ne Gjermani.

Akademia Ushtarake Kroate:

Viti i diplomimit		
	2019	
	M	F
Shqiptar	1	
Turk	1	
Gjithsej	2	

Akademia Ushtarake Gjermane:

Viti i diplomimit		
	2019	
	M	F
Shqiptar	2	
Gjithsej	2	

Të dhënat nga pranimit të kadetëve nëpër vite janë të dhëna të cilat dëshmojnë se është bërë përpjekje që të ruhet përfshirja e gjinisë femërore ndër vite. Ky përfaqësim i vogël i femrave kadete të Forcës së Sigurisë së Kosovës vërehet edhe me dhënat statistikore në tabelën në vijim me përqindje prej 8 % nga gjinia femërore ndërsa, 92 % nga gjinia mashkullore.

PROFILI I FEMRAVE NË FSK

Rezultatet e treguara nga anketa del se mosha mesatare e femrave të cilat shërbejnë në FSK, është 27 vjeç. Ndërsa, përgatitja shkollore e tyre del të jetë se 36 % kanë përfunduar shkollën e mesme, ndërkaj përgatitje universitare kanë 49 % dhe 15 % kanë mbaruar master. Nga studimi i të dhënave del se 45 femra ose 31 % nga numri i përgjithshëm i të intervistuarave janë të martuara dhe 32 prej tyre kanë fëmijë. Përqindja mesatare (e femrave të intervistuarave) e viteve të shërbimit në FSK është pesë (5) vite shërbim, ndërkaj, 113 prej tyre janë OR1- ushtar, OR3- Tetar 12 ; OR5- Rreshter 6; OR7- Kapter 5; OR8 – Rreshter major (dy) 2 ; OF1 –Toger 4 (kater); OF 2 –Kapiten (1); OFO1- Nëntoger pesë (5).

Tabela nr .1.

Mosha mesatare	27 vj.	
Me përgatitje shkollore të mesme	50	36 %
Universitar	69	49 %
Master	23	15%
Të martuara	45	31%
Me fëmijë	32	

Pozita e Femrës në Forcën e Sigurisë së Kosovës

Në pyetjen se, A mendoni se femrës në Forcën e Sigurisë së Kosovës i ofrohet mundësi e barabartë në shërbim?

Duke i krahasuar rezultatet e anketës vërehet se 107 ose 71% prej tyre janë përgjigjur se i ofrohen mundësi të barabarta në shërbim në FSK ndërsa, grupi i femrave që thonë se nuk kanë trajtim të barabartë është më i vogël gjithsej 24 sosh ose 16 %. Ndërkaj 20 (femra) ose 13% të anketuara nuk iu kanë përgjigjur kësaj pyetje.




Tabela nr.2


Arsyet :

- Infrastrukturë që nuk i plotëson nevojat për femrat (Banjo të përbashkëta gjatë kujdestarisë)
- Mungesë vetëdijesimi i stafit (meshkujve) për gjininë
- Vlerësohemi se ne femrat nuk jemi të përgatitura mjaftueshëm ushtarakisht,
- Vlerësime jo reale për femrat në uniformë

Në pyetjen: A keni hasur në ndonjë formë të diskriminimit dhe a e keni ngrit këtë çështje në nivelin tuaj më të lartë?

Duke u bazuar në Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020, neni 4 paragrafi 1. Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë gjinor, duke përfshirë trajtimin më pak të favorshëm të femrave për shkak të shtatzënisë dhe amësisë, gjendjes martesore, kombësisë, racës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, statusit social, besimit fetar dhe besimit, moshës ose ndonjë bazë tjetër të përcaktuar me ligj apo marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare në fuqi.

Ndërsa hulumtimi tregon se nga gjithsej 144 femra të anketuara 34 prej tyre, ose 24 % janë përgjigjur se kanë hasur në diskriminim, ndërkaq 110 ose 76 % janë përgjigjur se nuk kanë hasur në ndonjë formë të diskriminimit në punën e tyre.



Arsyet më të shpeshta që i kanë theksuar femrat se kanë ndjerë peshën e diskriminimit janë:

- Nën vlerësohemi se - femrat janë të dobëta fizikisht, nuk janë të përgatitura për ushtri
- Nuk vlerësohen vlerat ushtarake të një femre kjo ndodhë edhe gjatë gradimeve
- Nuk na jepet mundësia e trajnimeve për zhvillim në karrierë njësoj sikur meshkujve

Lidhur me këto shqetësime 13, prej tyre kanë deklaruar se e kanë ngritur çështjen në nivelin më të lartë por nuk janë të kënaqura me trajtimin e ankesave të tyre. Ndërkaq 34, femra janë përgjigjur se nuk e kanë ngritur çështjen për arsye se nuk merren parasysh ankesat dhe nuk trajtohen drejtë nga eprorët e tyre.

VËSHIRËSITË E FEMRAVE NË USHTRIMIN E DETYRËS NË FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS

Mentaliteti i shoqërisë, është një problem në vete kur bëhet fjalë për marrjen e vendimit të femrave për tu bërë pjesë e FSK. Ende konsiderohet se profesioni i ushtarakut është vetëm për meshkuj madje edhe femrat hasin në vështirësi në kryerjen e detyrës e sidomos gjatë rojeve natën ku ato kërkojnë që të shoqërohen edhe me nga një kolege femër. Për këtë – **është vlerësuar si vështirësi nga 30 % e femrave të anketuara**

Mos implementimi i ligjeve, është vlerësuar si vështirësi nga 6% e femrave të anketuara, duke theksuar se ky është problem serioz sepse ky vakum len hapësirë që problemet që hasim, mos të adresohen dhe të zgjidhen në mënyrën e duhur si është e përcaktuar me ligje, rregullore dhe akte të tjera të cilat janë në fuqi e që duhet të zbatohen nga të gjithë.

Vështirësi tjetër e ranguar në listën e vështirësive në ushtrimin e detyrës është edhe **Kujdestaria** për të cilën mendojnë 7% e femrave të anketuara. Vështirësitë që hasin ato gjatë kujdestarisë janë të ndryshme dhe ne po i përmendim vetëm disa nga ato: Kujdestari të shpeshta dhe të pandërprera, mungesë ndriçimi në pikat e kujdestarisë, infrastruktura e munguar dhe e domosdoshme etj. **Pushimi i lehonisë**, është vlerësuar si vështirësi dhe është konsideruar si i pamjaftueshëm nga 9% e femrave të anketuara, po ashtu edhe shtatzënia është vlerësuar si vështirësi nga 18% e femrave edhe pse shumica e femrave deklarojnë hapur se lirohen nga shumë aktivitete nga eprorët e tyre dhe nuk kanë ndonjë problem lidhur me bartjen e uniformës sepse mirëkuptohen nga të gjithë dhe përshtaten edhe me veshje civile.

Mungesa e sigurimit shëndetësor është vlerësuar si vështirësi me përqindjen më të madhe nga 22 % të femrave të anketuara, kjo duke u bazuar në faktin e ushtrimit të profesionit e që rezulton me rrezikshmëri të lartë kur kihet parasysh fakti se një numër jo i vogël i femrave kanë pësuar gjatë ushtrimeve fushore. Rëndësia e sistemit të sigurimeve shëndetësorë lidhet ngushtë me të drejtat themelore të njeriut.

Sigurimi shëndetësor paraqet një nga të drejtat themelore të njeriut dhe, rrjedhimisht, edhe parakusht që njeriu të mund t'i gëzojë shumë të drejta të tjera, kështu kjo e drejtë është i

inkorporuar në neni 22 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut që proklamon të drejtën në sigurim social, e cila e drejtë përfshihet edhe në shumë dokumentet të tjera të rëndësishme ndërkombëtare.


Si e drejtë elementare e njeriut, e drejta në sigurim shëndetësor është e rregulluar me norma ligjore vendore, ashtu edhe ato të karakterit ndërkombëtar. Veçanërisht, çështja e përkujdesjes shëndetësore është ndër çështjet më të ndjeshme me të cilën ballafaqohet shoqëria

Në kuadër të burimeve pozitive të së drejtës me të cilat rregullohet e drejta e njeriut në sigurim shëndetësor në Kosovë dhe në përgjithësi, bëjnë pjesë:

- Kushtetuta e Kosovës (15 Qershor 2008);
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948);
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale e Kulturore (1966);
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (1979);
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës (neni 1989) dhe
- Karta Sociale e Evropës (1961 & 1966).

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), ka bërë hapa shumë të rëndësishëm në këtë drejtim, me nënshkrimin e marrëveshjeve si me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës si dhe marrëveshja e bashkëpunimit në fushën e shëndetësisë ushtarake në mes të MFSK dhe Forcave të Armatosura të Turqisë. Kjo marrëveshje mundëson trajtimin e 50 pacientëve pjesëtar të MFSK-së dhe FSK-së në Spitalet Ushtarake të Turqisë dhe zbut në një far mase mungesën e ligjit për sigurime shëndetësore.

Pavarësisht se për ngacmimin seksual janë deklaruar një numër i vogël i femrave rreth 5% e të anketuarave mbetet shqetësim sepse ato deklarojnë se ka raste të ngacmimeve në vendin e punës por këto raste mbesin brenda njësisë dhe nuk ka raste që është ndëshkuar nga veprimet e tilla.



Njësia për të Drejtat e Njeriut, ka përdorë një pyetësorë të veçantë për të bërë një analizë dhe për të hetuar shkaktarët e dorëheqjes së femrave nga FSK, nga viti 2009-2015. Të dhënat janë të mbështetura në dosjet e femrave pjesëtare të FSK-së të cilat me rastin e dorëheqjes kanë plotësuar formularin me arsyetimin e dorëheqjes. Për këtë periudhë numri i femrave që kanë dhënë dorëheqje është 29 femra.

Në formularët e plotësuar dhe të nënshkruar nga vet femrat, rezulton se janë këto arsye:

- Arsyet personale
- Kushtet e punës
- Ndërrim statusi (nënkupton martesën)

Viti	Femra të larguara ndër vite
2009	7
2010	1
2011	1
2012	9
2013	7
2014	2
2015	2
Gjithsej	29


Tabela me numrin e femrave të larguara ndër vite

Viti	Meshkuj të larguar ndër vite
2009	97
2010	3
2011	25
2012	96
2013	59
2014	54
2015	37
Gjithsej	371


Tabela me numrin e meshkujve të larguar sipas viteve

Të dhënat e përgjithshme për pjesëtarët e Forcës Sigurisë së Kosovës, të cilët janë dorëhequr nga FSK janë 400 pjesëtar (femra e meshkuj). Nga ky numër 29 prej tyre janë femra dhe 371 janë meshkuj.

Nga ky numër vërehet se shifra e dorëheqjeve është ma e lartë te gjinia mashkullore, mirëpo po të krahasohet me numrin e përgjithshëm të femrave pjesëtare të FSK-së, kundrejt femrave që janë larguar apo kanë dhënë dorëheqje atëherë kjo përqindje është shumë më e madhe te femrat pjesëtare të FSK-së, sesa e meshkujve.



Forcën e Sigurisë së Kosovës e kanë braktisur gjithsejtë 29 femra ose 13% krahasuar me numrin e femrave pjesëtare të FSK-së 203.



Zhvillimi i karrierës për pjesëtarët femra të forcës së sigurisë së Kosovës

Sipas rezultateve të hulumtimit del se 65% e femrave vlerësojnë se, u ofrohet mundësi e barabartë (me meshkujt) për zhvillim në karrierë, 27% prej tyre mendojnë se nuk u ofrohet mundësi e barabartë. Arsyet të cilat i cekin ato për mundësi jo të barabarta me kolegët meshkuj janë: nuk na jepet mundësi e barabartë në ndjekjen e trajnimeve për zhvillim në karrierë në raport me meshkujt, mungesë e përkrahjes dhe mendimi se burrat janë më të denjë për ushtri, se burrat janë udhëheqës më të mirë etj. Ndërsa kësaj pyetje nuk iu kanë përgjigjur 8% e femrave të anketuara.





Tabela me femrat e intervistuar sipas gradave

OR1 Ushtare	113
OR3 Tetar	12
OR5 Rreshter	6
OR7 Kapter	5
OR8 Rreshter major	2
OF1 Toger	4
OF2 Kapiten	2

Në pyetjen e parashtruar : A mendoni se në njësinë tuaj u ofrohet mundësi e barabartë për gradim ?

Me përgjigjen Po, na ofrohet mundësi e barabartë janë 27% e femrave duke i marrë parasysh kriteret që duhet të plotësohen. Ndërkaq, deri diku janë përgjigjur 48 % e femrave të anketuara dhe Jo nuk ofrohen mundësi të barabarta për gradim 25 %.



GRADIMI- Në këtë hulumtim janë listuar edhe kriteret që duhet të plotësohen për gradim në FSK sipas Rregullores Nr. 06/2013 për Zhvillimin e Karrierës së Pjesëtarëve të FSK-së janë si në vijim:

- Niveli i duhur i edukimit – 3%
- Moshë dhe kohëzgjatja në shërbim- 22%
- Niveli i duhur i përgatitjes fizike - 10 %
- Niveli i duhur i ekzaminimit mjekësor- 0 %
- Niveli i duhur i trajnimit profesional – 12%
- Performanca e përmbushjes së detyrave në dy raportet e fundit të vlerësimit dhe rekomandimi për gradim - 13%
- Dosje disiplinore në ndalim të gradimit- 0 %
- Tjetër - 40 %

Rezultatet e nxjerra nga hulumtimi për mundësi të barabarta në gradim 40 % e tyre mendojnë se:

- Mundësi e vogël e kapaciteteve të FSK-së për Avancim (mungesa e vendeve të lira)
- Nuk vlerësohen drejtë dhe meritueshëm në vlerësime vjetore që ndikon në mos përmbushjen e kriterit të gradimit
- Nuk i ofrohet mundësi e barabartë të zhvillimit të karrierës (trajnime bilaterale, kurse për zhvillim në karrierë)

- Edhe nëse i plotësojmë të gjitha kriteret nuk avancohemi për arsye të mungesës së besimit se një femër nuk din të udhëheqë në mënyrë profesionale sikur kolegët e tyre meshkuj
- Femrat avancohen vetëm për shkak se duhet plotësohen kuotat e jo për kontributin e tyre që japin çdo ditë.
- Gradimi bëhet në baza të nepotizmit e jo të meritokracisë

Konkluzionet:

- Numri i femrave në uniformë në FSK, është rritur në mënyrë sistematike por, ende mbetet i vogël.
- Numri i femrave të dorëhequra në FSK, nuk konsiderohet i vogël.
- Është rritur ndër vite numri i femrave që kanë konkurruar në FSK
- Infrastruktura në disa kazerma të FSK-së , nuk i plotësojnë kushtet e nevojshme për femrat në detyrë.
- Transferimi në distanca të larta, pamundëson kujdesin e grave të FSK-së për fëmijët e tyre (sidomos për nënat me fëmijë të vegjël)
- Pushimi i lehonisë është konsideruar i shkurtër dhe është theksuar si vështirësi në ushtrimin e profesionit të tyre.
- Numri i femrave të trajnuara është i kufizuar krahas numrit të meshkujve pjesëtar të FSK
- Ka indikacione se ka ngacmime seksuale në vendin e punës
- Sipas rezultateve të hulumtimit, ankesat nuk shqyrtohen drejtë dhe seriozisht në pajtim me aktet Ligjore në MFSK dhe FSK
- Vlerësimet vjetore dhe gradimet nuk bëhen në pajtim me Rregulloret në fuqi.
- Mungesa sigurimit shëndetësor mbetet si shqetësim për të gjithë pjesëtarët e FSK-së, edhe pse në masë të madhe e kanë zbutur marrëveshjet Bilaterale si p.sh me Turqinë ku të drejtën e shërimit në vit e kanë 50 pjesëtarë.

Rekomandimet:

- Të synohet përfshirja më e lartë e femrave në FSK , 12 % (është parapa në PV. miratuar nga Qeveria e Kosovës)
- Të merren parasysh vështirësitë e femrave pjesëtare të FSK-së në ushtrimin e detyrës .
- Të aplikohen politika afirmative për femrat në FSK (trajnime, bursa për shkollim etj).
- Të mbahen trajnime parandaluese lidhur me diskriminimin dhe ngacmimin seksual.
- Të shqyrtohen seriozisht ankesat e pjesëtarëve të FSK-së në pajtim me Ligjet, Rregulloret dhe aktet tjera normative në fuqi.
- Pushimi i lehonisë të jetë në pajtim me Ligjin e Punës dhe Aktet tjera normative në MFSK/FSK
- Të kihet në konsideratë nënat me fëmijë të vegjël nga roja e natës dhe detyrat në distanca të largëta.

Me respekt!